



Më
Dana

20-06-2017

P.nr.1252/2014

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM -
DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër, [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga [REDAKTUAR], akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.875-5/14 të dt.21.11.2014, sipas së cilës e ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 par.1 të KPK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.20.02.2015 solli

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.875-5/14 të datës 21.11.2014, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit [REDAKTUAR], mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 25.02.2014, në shtëpin e tij në Ferizaj, me rastin e kontrollit të njehsorit elektrik me numër [REDAKTUAR] nga ana e punëtorëve të autorizuar të KEDS-it përkatësisht nga ekipi i shkyçjes është konstatuar se konsumatori ka dëmtuar vulat zyrtare-bllombën distributive me nr [REDAKTUAR], të cilën e kanë venë punëtorët të autoizuar të KEDS-it, Distrikti në Ferizaj, plombë e cila ishte vendosur me datën 18.02.2014 kur ishte bërë ç'kyçja për shkak të borgjit,-

- me të cilën kreu veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga nen.414 par.1 të KPK-së.

- Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akzuarit [REDAKTUAR] i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

E dëmtuara KEDS- Distrikti në Ferizaj nuk e ka precizuar dëmin që i ka shkaktuar i akuzuari gjykata për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të gjitha nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.875-5/14 të dt.21.11.2014 , ka akuzuar [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga [REDAKTUAR], përshkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga nen.414 par.1 të KPK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 414 par.1 të KPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjyqtari ka lexuar kallximin penal të KEDS-it-Distrikti në Ferizaj me nr.CMS/DFE-406,të datës 25.03.2014, procsverbalin me nr.0977858 të datës 18.02.2014 dhe procesverbalin me nr.0945859 i dt.25.02.2014 dhe ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së e dëmtuara KEDS- Distrikti në Ferizaj për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjellë në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P.nr.1252/2014 me dt.20.02.2015

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.